

# STATUTI

## STATUTI

### I

#### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “Unlimited Business Investments “ Sh.P.K

Sot më datë 16.01.2023, duke u bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" i ndryshuar, unë e nënshkruara shprehim vullnetin tim të lirë dhe të plotë, për të nënshkruar këtë statut me qëllim krijimin e shoqërisë "Unlimited Business Investments" sh.p.k.- si më poshtë vijon;

### KREU I

#### Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

### NENI 1

#### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot, në datë 16.01.2023, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Unlimited Business Investments" Sh.P.K

1.2 Themeluesja e shoqërisë është :

I. **Teuta Koxhaj**, e bija e Bujarit, e datëlindjes 04.09.1973 , lindur Lushnje dhe banues në Tirane ne adrese:Rr. Eduart Mano, pall nr.26, apt nr.8 mbajtëse e kartes se identitetit 035373752 dhe Nr. Personal H35904103F , me Kombesi Shqiptare, zoteruese e 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Teuta KOXHAI ka vendosur krijimin e shoqërisë dhe miratimin e statudit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë veçanërisht sipas Ligjit 9901 dt 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe si person juridik të zhvillojnë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

### NENI 2

#### Objekti

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

*Ofrimin e Sherbimeve te Konsulences financiare dhe fiskale, plane biznesi dhe marketingu, Konsulence dhe Ekspertize bankare, sherbime negociimi dhe perfaqesimi prane paleve te treta per kreditime dhe rikuperim te kredive si individuale dhe te shoqerive, Shoqëria do të japë konsulencë biznesi në fushën e investimeve financiare, ndërmjetësim ligjor për kompani dhe individë që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj. Ndërmjetësim të përgjithshëm për kompani dhe individë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Konsulenca për strukturim ose ristrukturim, planifikim dhe zhvillim të mënyrës së organizimit të kompanive. Shërbim përfaqësimi ndaj shoqërive tregtare, individëve dhe tregtareve, qofshin këta vendas apo të huaj. Vlerësimi dhe përpilimin e kontratave të kompanive para apo gjatë lidhjes së marrëveshjeve. Agjenci imobiliare. Studime tregu per pasuri te paluajtshme, komisioner dhe agjensi per te tretet. Trajnim dhe konsulence ne trajtimin dhe shitjen e pasurive te paluajtshme.*

*Ndermjetesim dhe Konsulence per shitje dhe blerje, qiramarrje dhe qiradhenie te pasurive te palujtshme e te luajtshme, veprimtari ekonomike ne fushe e Real Estate. Negocime, ndermjetesime, perfaqesime te te treteve ne fushen e Real Estate, si ne tregun e brendshem ashtu edhe ne ate nderkombetar, si dhe cdo transakcion tjeter ne funksion te permbushjes se objektit te veprimtarise ne fushe e Real Estate; dhe cdo sherbim tjeter ne lidhje me tregun imobiliar ne te gjithë nivelet e sherbimit.*

*Kryerjen dhe ofrimin e Konsulences Ligjore te fokusuar ne ceshtjet tregtare, civile, fiskale dhe taksat, pasurite e paluajtshme, pronesite, pronesite intelektuale, ligjin penal, ofrimi i shërbimeve të konsulencës*

*për persona fizikë e juridikë vendas dhe të huaj si përgatitje dokumentacioni apo dokumentash të ndryshme sipas nevojave të klientëve, depozitim apo tërheqje dokumentash a lejesh të ndryshme pranë institucioneve shtetërore e private, përgatitje projektesh, studimesh, relacionesh, plan biznesesh, studime tregu e studime të ndryshme me karakter informues për klientët apo partnerët e Shoqërisë në të gjitha fushat, konsulencë strategjike, marketingu, financiare dhe kontabël, si dhe aktivitetet e ndërmjetësimit konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.*

*Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e konsulencës në gjithë sektorët e industrite në vend, të kryejë në Shqipëri dhe jashtë shtetit të gjitha operacionet (veprimet) komerciale, industriale dhe financiare, të tundshme dhe të patundshme të shoqërive të tjera. Shoqëria ka në objektin e saj të aktivitetit si Import, eksport mallrash dhe produktesh të gjitha llojeve, makinerish dhe pajisjesh, mjete transporti, etj, si dhe aktivitetin e shpërndarjes dhe përdorimit të këtyre shërbimeve të ndryshme në favor të të tretëve, operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndërtime objektesh industriale e civile, prodhime inertesh e material ndërtimi, financime, të luajtshme e të paluajtshme e financime të ndryshme si dhe çdo objekt tjetër që nuk bie në kundërshtim me ligjin. Krijimin, administrimin dhe përhapjen e bazave të të dhënave në sisteme të kompiuterizuara të administruara nga Shoqëria, tregtim programesh kompiuterike, software, hardware, shërbime elektronike, pjesë këmbimi, etj. Krijimin, çeljen dhe administrimin e call center për ofrimin e shërbimit ndaj klientit për të gjitha llojet e shërbimeve të mundshme në të gjithë sektorët e fushat ku mund të operohet, shitje produktesh, kontratash e shërbimesh të ndryshme për llogari të Shoqërisë apo të të tretëve me telefon, online, apo me çdo mënyrë tjetër kontakti të parashikuar.*

### **NENI 3 Kohëzgjatja**

- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakëve të shoqërisë.

### **NENI 4 Selia**

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga Zef Jubani, Pallati Bjorn, Kati 3, Apt.22, Tirane.**

### **KREU II Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njqind mije) Leke. Ortake e vetme themeluese do të jete Teuta Koxhaj zoteruese e 1(nje) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 Lekë që përben **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

### **NENI 6**

#### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar dhe licensuar për këto kontribute me vendim asambleje të shoqërisë sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit, vendimet merrën me 2/3 e kuotave pjesëmarrëse
- 6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, ndërsa për persona të tjerë jashtë shoqërisë do të funksionojë e drejta e parablerjes, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU III

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

## Neni 8

### Organi Vendimmarres

- 8.1 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 8.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## Neni 9

### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.



- 9.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10 Kuorumi**

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 11 Marrja e vendimeve**

- 11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

#### **Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës**

- 12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 12.1 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### **Neni 13 Administrimi**

- 13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- 13.2 Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 13.3 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 13.4 Administrator i shoqërisë do të jetë **Teuta Koxhaj**, e bija e Bujarit e datëlindjes 04.09.1973 , lindur Lushnje dhe banues në Tiranë në adresë: Rr. Eduard Mano, Pall, nr. 26, Apt.nr.8, mbajtëse e kartes së identitetit 035373752 dhe Nr. Personal H35904103F

#### **Neni 14**



## Kompetencat e Administratoreve

- 14.1 Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:
- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 14.2 Administratoret janë të detyruar të therasin Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 14.3 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 14.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Përgjegjësia e Administratoreve

- 15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 15.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 15.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 15.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga



- këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 15.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueese për të shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi.
- 15.7 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit
- 15.8 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **KREU IV** **Viti financiar-ekspertet**

##### **Neni 16** **Viti Financiar**

16. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17** **Ekspertet**

- 17.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 17.2 Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **Kreu V** **Prishja --riorganizimi i shoqërisë**

##### **Neni 18**

##### **Prishja dhe likuidimi**

- 18.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
  - d) me vendim të gjykatës;
- 18.2 Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqëri në likuidim e sipër “.
- 18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket me vendim asambleje



- 18.5 Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**

**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

- 19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 20**

**Baza Ligjore**

- 20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 20.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**

**Mosmarrëveshjet**

- 21.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKËT**

**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"Unlimited Business Investments " SH.P.K.**

*Ortak i vetem*

**Teuta KOXHAI**

